



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
RAPORT GJYSMËVJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR
PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2025

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këtu e në vijim, MSHMS) ka konsultuar nëpërmjet takimeve dhe tryezave të konsultimit me aktorë jo qeveritarë si dhe aktiviteteve të tjera konsultative 1 (një) projektakt si vijon:

1. Projektvendimi “Për miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij”.

Vlerësohet se procesi, në raport me periudhën e kaluar (vitin 2024), paraqet një trend të kënaqshëm duke patur një numër të madh aktorësh të përfshirë, sidomos nga organizatat joqeveritare për shkak të ndjeshmërisë në lidhje me çështjet të cilat trajton projektvendimi.

Takimet konsultative janë zhvilluar nëpërmjet platformave të ndryshme ndër to tryezat e përbashkëta dhe nëpërmjet e-mailit. Ky projektakt nuk është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (këtu e në vijim RENjKP).

Në takime kanë marrë pjesë aktorë joqeveritarë të profileve të ndryshme si ekspertë të fushës, shoqata dhe organizata ndërkombëtare.

Njëkohësisht, Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani i Veprimit 2025-2030 është konsultuar dhe miratuar nga Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Vendore dhe Komiteti i Planifikimit Strategjik, përkatësisht:

- Në datë 30.04.2025 në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik (KPS), dhe
- Në datë 08.05.2025 në mbledhjen e Këshillit Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Për 6 mujorin e I-rë të vitit 2025 është konsultuar nëpërmjet takimeve dhe tryezave të konsultimit me aktorë jo qeveritarë si dhe aktiviteteve të tjera konsultative 1 (një) Projektakt “Dokumentit Politik për Moshimin dhe Plani i Veprimit 2025-2030”.

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri total i akteve të miratuara në këtë gjashtëmujor janë 11 projektvendime.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Numri i akteve të cilat i janë nënshtruar konsultimit publik është një, Projektvendimi “Dokumenti Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030”. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 10 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Projektvendimi i miratuar gjatë kësaj periudhe nuk është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

2.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për 7 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2025, për 2 prej tyre janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik. Aktet e përjashtuara nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik nuk kanë qenë të parashikuara në PKIE apo të kenë lidhje me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Një projektvendim, “Dokumenti Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030”.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me gjashtëmujorin e një viti më parë situata mbetet e njëjtë, konkretisht është konsultuar 1 projektvendim.

2.2 Metodatat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

➤ Për procesin e konsultimit të Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030, janë përdorur metoda konsultimi si më poshtë:

- Takime konsultimi të drejtpërdrejta me anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhër Ministri 536/2024 me përfaqësues nga ministrinë dhe institucionet;
- Takime konsultimi me grupet e ndryshme të interesit nga organizatat e shoqërisë civile aktive dhe kontribues në fushën e moshës së tretë, qendra ditore dhe rezidenciale të moshës së tretë si dhe përfaqësues të organizatës ndërkombëtare Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Qendrës Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim (QSHPHZ);.

- Takime online konsultimi për dhënie kontributi me përfaqësues të Zyrave të Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale të Njësive të Qeverisjes Vendore (61 bashkitë e vendit);
- Korrespondenca përmes postës zyrtare elektronike (adresë E-mail: @shendetsia.gov.al), ndarë me të gjithë grupet e interesit të përfshirë në procesin e konsultimeve;
- Korrespondenca me shkresë zyrtare dërguar përfaqësuesve të institucioneve anëtarë të Grupit të punës sipas Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 536/2024, për mendime mbi Planin e Moshimit.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Në projektaktin për konsultimin publik të “Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planit të Veprimit 2025-2030”, metodat e konsultimit që gjeneruan më shumë komente dhe u përfshuan mendime dhe kontribute janë: takimet e drejtpërdrejta, emaillet dhe shkresat zyrtare të dërguara nga institucionet anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe grupet e interesit që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Projektakti i Dokumentit Politik të Moshimit 2025-2030, iu dërgua për mendim me shkresë zyrtare 16 institucioneve, 9 institucione përfaqësues anëtarë të grupit të punës, si dhe: Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka organizuar konsultime paraprake për hartimin e projektaktit “Dokumenti Politik i Moshimit dhe Planit të Veprimit 2025-2030”, përmes takimeve të realizuara përkatësisht:

- ✓ 05 Dhjetor 2024, takimi me anëtarët e Grupit të Punës, të ngritur me Urdhër Ministri nr. 536, datë 16.10.2024, përfaqësues të ministrisë së linjës, (*institucione në nivel qendror dhe varësisë*).
- ✓ Në datë 12 Shkurt 2025, takim përgatitor online me ekspertët e caktuar për përgatitjen e Raport-vlerësimit përfundimtar të zbatimit të Planit të Veprimit të Moshimit 2020-2024.
- ✓ 19 Shkurt 2025, takim me përfaqësues të institucioneve qendrore, anëtarë të Grupit të Punës, dhe ekspertët e caktuar në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2025-2030.
- ✓ Shkurt 2025, takim me fokus shërbimet dhe kujdesin shëndetësor ndaj moshës së tretë, me përfaqësues të grupit të punës si dhe institucione qendrore, dhe varësisë.
- ✓ 13 Mars 2025, takim konsultues online në bashkëpunim me ekspertët e Planit të Moshimit dhe përfaqësues të Drejtorive të Shërbimeve Sociale të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social.
- ✓ 3 Prill 2025, takim konsultues me përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile, që mbështesin dhe mbrojnë të drejtat e moshës së tretë në vend.

Gjithashtu, Dokumenti Politik i Moshimit 2025-2030 është miratuar dhe nga Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Vendore dhe Komiteti i Planifikimit Strategjik përkatësisht:

- ✓ Në datë 30.04.2025 në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik (KPS), dhe
- ✓ Në datë 08.05.2025 në mbledhjen e Këshillit Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Kohëzgjatja e procesit të konsultimit publik për Projektvendimin “Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030, ka zgjatur nga data 05.12.2024 – 27.05.2025.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e procesit të konsultimit publik të projektaktit të Dokumentit Politik të Moshimit dhe Planit të Veprimit 2025-2030 është mesatarisht 6 muaj .

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim të konsiderueshëm të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike e takime.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në hartimin e projektaktit të Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030 morën pjesë si palë të interesuara si Autoriteti i Mediave Audiovizive, Banka e Shqipërisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

*2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)
Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC).*

Në procesin e hartimit të Dokumentit të Moshimit, ishin 10 përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile apo/dhe grupet e interesit, ku 5 përfaqësues ishin Kryetarë të shoqatave të moshës së tretë si dhe 5 Drejtues ekzekutivë të qendrave ditore dhe rezidenciale që mbështesin dhe punojnë në përmirësim të mirëqënies së moshës së tretë.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Përsa i përket Dokumentit Politik të Moshimit dhe Planit të Veprimit 2025-2030, në datën 3.04.2025 u zhvillua takimi konsultues me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të grupeve të interesit si: Shoqata "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë"; Shoqata "Shoqëria për të gjitha Moshën" ASAG; Qendra Sociale "Te Moza"; Qendra "Franklin"; Qendra e përkujdesit "Rrezet e Jetës"; Qendra për Administrim Social Ekonomik Territorial "ASET"; Qendra "Shtëpia e Zotërinjve"; Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë që mbështesin dhe mbrojnë të drejtat e moshës së tretë në vend për konsultimin e përparësive, objektivave dhe aktiviteteve në mbështetje dhe përmirësim të mirëqënies së këtij grupi social.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Për Dokumentin Politik të Moshimit 2025-2030, numri i kontribuesve në takimet e konsultimit parapërgatitor ishte si më poshtë:

- Numri i kontribuesve/përfaqësues ndërinstitucional ishte 14 institucione në nivel qendror/varësi, anëtarë të Grupit të Punës /Urdhër Ministri nr.536/2024 dhe institucione të tjera: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Numri i kontribuesve në konsultim për dhënie kontributi dhe mendimi ishte 9 përfaqësues të OJF-ve, (qendra sociale ditore dhe rezidenciale), shoqata të shoqërisë civile dhe grupe interesi që mbrojnë dhe mbështesin çështjet e moshimit;
- Numri i kontribuesve nga njësitë e qeverisjes vendore ishte 61 përfaqësues të Zyrave të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale të Njësive të Qeverisjes Vendore (bashki);
- Numri i kontribuesve /përfaqësues si partner ndërkombëtar të pranishëm ishte 1 përfaqësues Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA).

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

- ✓ Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar, duke qënë se ka patur një përmirësim të dukshëm përsa i përket interesit të shtuar, treguar në të gjitha takimet konsultative paraprake të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes:
- Pjesëmarrjes aktive të grupit teknik ndërinstitucional, njësive të vetëqeverisjes vendore, dhe grupeve të interesit të shoqërisë civile;
- Dhënies së mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve për çdo objektiv specifik, aktivitet dhe/apo masë konkrete në zbatim të planit të veprimit.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Numri i komenteve nga organizatat e shoqërisë civile gjatë takimeve për konsultimin e Dokumentit të Moshimit ishte 22, pjesa më e madhe komente specifike.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Lidhur me Planin Kombëtar për Moshimin 12 Komente u pranuan plotësisht, 7 komente pjesërisht dhe 3 komente u refuzuan.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet takimeve publike, mbetet e kënaqshme dhe sa vjen e përmirësohet, pasi pothuajse 80 % e komenteve të marra, janë reflektuar.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Projektvendimi i miratuar gjatë kësaj periudhe nuk është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Raporti i konsultimit publik për Projektaktin “Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani i Veprimit 2025-2030”, nuk është publikuar në RENJKP, pasi dhe vet akti nuk është publikuar.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Raporti i konsultimit publik për Projektaktin “Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani i Veprimit 2025-2030”, nuk është publikuar në RENJKP, duke qënë se ky projektvendim u konsultua nëpërmjet tryezave dhe cdo forme tjetër konsultimi, por nuk u konsultua nëpërmjet RENJKP.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

MSHMS vlerëson se konsultimi i dokumentit të miratuar për vitin 2025, që i është nënshtruar konsultimit publik ka qënë në nivel shumë të mirë.

Në konsultimin e tyre janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh. Dokumenti ka patur forume të ndryshme konsultimi, si tryezat e përbashkëta, nëpërmjet të cilave janë sjellë komente dhe feedback nga institucionet dhe shoqëria civile si dhe ndërgjegjësimin për çështjet në fusha të ndryshme të aktivitetit shoqëror.

Sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose jo dhe pse.

Për këtë arsye, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është vetëvlerësuar me (6) pikë, duke qënë se procesi është zhvilluar nëpërmjet takimeve dhe tryezave, por nuk është publikuar në RENJKP.

3 **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat mbeten përdorimi i RENjKP dhe përfshirja e sa më shumë aktorëve joqeveritarë.

Takimet konsultative të tipit Hibrid (online dhe takime ballë për ballë) mendojmë që janë te vlefshme sepse kursejnë kohën e pjesëmarrësve dhe sigurojnë pjesëmarrje pothuaj të plote të të ftuarve.

Një trend pozitiv është numri i lartë i pjesëmarrësve të pranishëm (jo thjesht të ftuar). Kjo tregon interes nga popullsia për të diskutuar mbi çështjet madhore të shoqërisë. Sidoqoftë mbetet sfiduese që të pranishmit ta shprehin angazhimin nëpërmjet komenteve dhe jo thjesht pjesëmarrjes.